



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Integrimin European

PROCESVERBAL

Tiranë, më 12.12.2019, ora 09:00

Drejton mbledhjen:

Senida Mesi – nënkryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Shqyrtimi i projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”
2. Shqyrtimi i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”.
3. Të tjera

Marrin pjesë:

Senida Mesi, Musa Ulqini, Ilir Pendavinji, Taulant Balla, Mirela Kumbaro, Ralf Gjoni, Nikolin Staka, Edlira Hyseni, Kostaq Papa, Aurora Mara, Andrea Marto, Halit Valteri, Ervis Meço dhe Arlind Çarçani.

Mungojnë:

Rudina Hajdari, Fatmir Velaj, Arben Kamami, Klodiana Spahiu dhe Sadri Abazi.

Të ftuar:

Elisa Spiropali - Ministre Shteti për Marrëdhëniet me Parlamentin
Elira Kokona – Zëvendëssekretare e Përgjithshme në Këshillin e Ministrave
Besmir Beja - Drejtor i Drejtorisë së Kodifikimit në Ministrinë e Drejtësisë
Enea Karakaçi - përfaqësuese nga Drejtoria për Integrimin European në Ministrinë për Energji dhe Infrastrukturën
Irena Malolli - Drejtoreshë
Suela Jahja – Këshilltare në Ministrinë për Marrëdhëniet me Parlamentin

HAPET MBLEDHJA

Senida Mesi – Mirëdita!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit për Integrimin European me agjendën sipas rendit të ditës:

Shqyrtimi i projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”” dhe shqyrtimin e projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin 9918, datë 19.05.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar””, si the të tjera, sipas propozimit të anëtarëve të këtij komisioni.

E pranishme sot është zonja Elisa Spiropali, Ministre Shteti për Marrëdhëniet me Parlamentin, si rezultat i pamundësisë të të dy ministrave përgjegjës për projektligjet konkrete, të angazhimeve në Shtabin e Emergjencave për zonat e prekura nga tërmeti.

Zonja Ministre, ju falënderoj shumë që gjetët kohë të vini në Komisionin për Integrimin European!

I pranishëm është edhe zoti Besmir Beja, drejtor i Drejtorisë së Kodifikimit në Ministrinë e Drejtësisë, Enea Karakaçi, përfaqësues i Drejtorisë për Integrimin European në Ministrinë e Energjisë dhe Infrastrukturës, zonja Irena Malolli dhe zonja Suela Jahja, këshilltare në Ministrinë për Marrëdhëniet me Parlamentin.

Arsyeja pse ne kemi kërkuar nga dy ministratë përkatëse të vijnë të trajtojnë dhe të japin mendim për këto dy projektligje është se në bazë të nenit 19 të Rregullores së Kuvendit, të nenit 10 të ligjit nr. 15/2015 “Për rolin e Kuvendit në procesin e integritit të Republikës Shqipërisë në BE” Komisioni për Integrimin European ka në kompetencë të tij shqyrtimin e përputhshmërisë së legjislacionit shqiptar me *acquis* të BE-së. Pra, ajo që trajtojmë në këtë komision nuk është trajtimi nen për nen, se përgjegjës është edhe Komisioni i Ligjeve, por trajtojmë pjesën e përputhshmërisë së këtij ligji (relacioni dhe projektligji janë të shoqëruara me tabelat e përputhshmërisë), pra së bashku me Drejtorinë e Përafrimit të Legjislacionit në Kuvend, trajtojmë nivelin e përafrimit, nëse është i pjesshëm, apo tërësor dhe komentojmë e bëjmë modifikimet e duhura në lidhje me atë që ky komision ka marrë përsipër. Në rastin konkret në relacion përmendet fakti që të dyja ndryshimet e këtyre projektligjeve kanë për qëllim përafrimin me legjislacionin e *acquis communautaire* të BE-së dhe direktivat përkatëse. Neve na mungonte tabela e përputhshmërisë.

Zonja Ministre, unë do të doja një përshkrim të detajuar dhe të ndaleshit të kjo çështje e rëndësishme për trajtim në këtë komision.

Elisa Spiropali – Faleminderit, zonja kryetare!

Kam kënaqësi që jam në këtë komision për të prezantuar këtë paketë!

“Shumica e njerëzve nuk e duan lirinë, sepse liria vjen me përgjegjësi dhe janë të trembur nga përgjegjësia” – thotë një shprehje e urtë. Diversiteti informativ sot është alternimi i metodave të ndryshme, duke nisur nga mediet klasike e deri tek ato informative *online*, madje mediet klasike janë atashuar direkt me platformat *online*, po përmend këtu *live streaming*, gazetatat që lexohen në *press reader online*, e shumë forma inovative, që janë një aset në një epokë teknologjie, e cila çdo ditë përparon e nga e cila mund të marrësh informacion në kohë reale, mund të prodhosh debat, mund të denoncosh, etj. Por kur këto metoda përdoren për përfitime të pastra dhe *paid for click* është dukshëm një tendencë për ta bërë këtë shpesh pa asnjë esencë vërtetësie dhe pa asnjë përmbajtje gazetareske, ku mbi gjithçka është verifikimi i lajmit. Ndodh që të dëgjojmë çudira nga më kalimtarët deri tek ato më të rëndat, si, për shembull, vdekje me pahir të njerëzve, diskriminim masiv, sharje vulgare, tituj denigruese, *fake news*, por edhe raste flagrante kur interneti të hyn në dere të shtëpisë dhe e gjen veten bashkë me biografinë familjare të publikuar *online*.

Paketa antishpifje e propozuar është në përputhje me objektivat e qeverisë shqiptare, por edhe më gjerë, për garantimin dhe mbrojtjen e dinjitetit dhe të të drejtave themelore të njeriut, të drejtës për informacion dhe ndërgjegjësimin të opinionit publik lidhur me respektimin e normave morale dhe etike nga ofruesit e shërbimeve të publikimeve elektronike.

Paketa antishpifje parashikon amendimin e ligjit “Për mediet audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, AMA, dhe ligjit “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” dhe ka për qëllim disiplinimin dhe normimin me ligj të shërbimit të medias në tërësi dhe të shërbimit të publikimeve elektronike në veçanti, për shkak të rritjes së impaktit të tyre në aspektin social, kulturor, ekonomik dhe politik të shoqërisë shqiptare, një fenomen që haset gjerësisht edhe në vende të tjera. Ky debat nuk është ekskluziv për Shqipërinë, por ka një shtrirje të gjerë aty ku demokracia është vibruese.

Pjesë e kësaj pakete është ndryshimi i propozuar në Kodin Penal për mbrojtjen e të drejtës së autorit. Nisma ligjore është ndërmarrë nga Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës. Shqetësimi për përhapjen në kohë reale të lajmeve të rreme në epokën digjitale dhe ndikimi negativ që ka dezinformimi, besueshmëria dhe pavarësia e gazetarisë profesionale të vlerat demokratike dhe të drejtat e njeriut, janë gjithashtu një problematikë, që dikton nevojën për ndërhyrje legjislative, me qëllim parandalimin dhe reduktimin e efekteve negative, që kanë sjellë në shoqëri keqinformimi dhe përhapja e lajmeve

të rreme nga portalet *online*, të cilat kanë një ndikim të konsiderueshëm, pasi lehtësojnë mundësinë e ndërveprimit social dhe të shkëmbimit të informacionit mes individëve.

Mungesa e një rregullimi shterues lidhur me veprimtarinë e ofruesve të shërbimeve të publikimeve elektronike, të cilat po shmangin dhe po zëvendësojnë mediet tradicionale për shkak të lehtësisë së aksesit të çdo individi dhe përdorimit të portaleve *online* nga një numër i pakufizuar personash, e bën akoma më të nevojshme ndërhyrjen legislative.

Në legjislacionin aktual në fuqi nuk parashikohen qartësisht sanksionet ligjore për mosrespektimin e detyrimeve përkatëse sa u takon kufizimeve të publikimeve të përmbajtjeve të paligjshme apo të dëmshme.

Prandaj për të mbrojtur veçanërisht dinjitetin dhe reputacionin e individit, të miturit nga përmbajtjet e dëmshme dhe të gjithë qytetarët nga nxitja e urrejtjes, dhunës etj. propozohet amendimi i ligjit “Për mediet audiovizive”, duke përfshirë në kontekstin e tij edhe rregullimin e medieve elektronike.

Gjithashtu është shumë e rëndësishme të theksohet që pavarësisht ndryshimeve të propozuara, ky projektligj në asnjë dispozitë nuk cenon lirinë e shprehjes dhe pluralizmin e tregut të medias audiovizive dhe elektronike, por synon përcaktimin e disa rregullave dhe vendosjen e disa standardeve etike, në mënyrë që të respektohet dinjiteti dhe të drejtat themelore të njeriut, si dhe të përmirësohet cilësia e informimit dhe e debatit publik. Përparësitë dhe efektet e kësaj pakete janë të qarta. Teknologjia digjitale mund të shërbejë si një forcë e fuqishme për të minuar proceset demokratike dhe lajmet e rreme shkatërrojnë cilësinë e diskutimit në demokraci dhe në marrëdhëniet e qytetarëve jo vetëm me qeverinë, me autoritetet, pra me shtetin, por edhe me njëri-tjetrin. Ndaj është i nevojshëm përcaktimi i disa rregullave ligjore dhe standardeve etike e profesionale, me qëllim parandalimin e këtij fenomeni.

Zhvillimet digjitale kanë krijuar mundësitë për përfshirjen e llojeve të reja të shërbimeve dhe aktiviteteve, që kanë ndikuar në mënyrat e ndërveprimit social dhe formësimin e individëve nëpërmjet përhapjes së informacionit me lehtësi dhe aksesit të pakufizuar, për të mos folur për ndikimin që mund të kenë mediet sociale në formimin e brezit të ri, duke krijuar shpesh paragjykime, apo urrejtje, seksizëm të përhapur, urrejtje racore e fenomene të tjera flagrante. Ndryshimet e shpejta, që po ndodhin në shoqëri si në fushën e teknologjisë, shkencës, ekonomisë, etj, kanë ndikim edhe në krijimin e normave të reja ligjore, që nuk janë parashikuar më parë. Në momentin e miratimit të ligjit “Për mediet audiovizive” në vitin 2013 roli i teknologjisë dhe internetit në përhapjen e informacionit, nuk ishte në dimensionet që ka arritur sot informimi përmes medieve elektronike. Në këto kushte duke mbajtur në fokus veçanërisht influencën e portaleve *online* gjatë viteve të fundit, është parë e nevojshme që të ndërmerret

kjo nismë, me qëllim që zhvillimet teknologjike e sociale të ecin paralelisht me evoluimin e kuadrit ligjor.

Miratimi i kësaj paketë ligjore synon krijimin e një kornize për rregullimin dhe disiplinimin e përmbajtjes së informacionit të ofruar nga media me qëllim garantimin e të drejtës së informimit, të lirisë së shprehjes, mbrojtjen e dinjitetit, garantimin e ruajtjes së jetës private, moslejimin e transmetimeve që nxisin intolerancën mes shtetasve, si dhe moslejimin e transmetimeve që nxisin, apo justifikojnë dhunën.

Gjatë hartimit të këtyre projektligjeve janë studiuar legjislacionet dhe modelet e shteteve të tjera, si: Gjermania, Mali i Zi, Letonia dhe Kroacia dhe është konstatuar se rregullimi i përmbajtjes së publikimeve elektronike është normuar me ligj edhe në këto shtete. Gjatë hartimit dhe përgatitjes të dispozitave konkrete është marrë si model ligji kroat “Për mediet elektronike”, i cili që në nenin 1 të tij parashikon se ky ligj rregullon të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e personave juridikë dhe fizikë, që ofrojnë shërbime mediatike audio dhe audiovizuale, si dhe shërbimet e publikimeve elektronike nga rrjetet e komunikimit elektronik, duke vijuar më pas rregullimin e veçantë të secilit shërbim në dispozita konkrete të ligjit. Ky projektligj është në përputhje me direktivën 13 të BE-së të vitit 2010, të Parlamentit Europian, dhe të Këshillit, datë 10 mars 2010, për koordinimin e disa dispozitave të parashikuara me ligj, rregullore apo akte administrative në shtetet anëtare lidhur me ofrimin e shërbimit të transmetimeve me zë dhe figurë. Direktiva për shërbimit mediatik me zë dhe figurë, versioni i kodifikuar në Fletoren Zyrtare, është amenduar së fundmi me argumentimin se nga momenti i miratimit të kësaj direktive, tregu i shërbimeve audiovizive të medias ka evoluar në mënyrë domethënëse dhe të shpejtë, për shkak të konvergjencës së vazhdueshme të televizionit dhe shërbimeve të internetit. Në këtë aspekt nevojiten disa amendime për të normuar efektet dhe influencën e medieve *online* dhe shërbimeve të internetit. Ndjekja e modelit të një shteti anëtar të BE-së, si Kroacia dhe përputhja e plotë me direktivat e BE-së, duke e përshtatur me kontekstin shqiptar është një tjetër argument bindës që vërteton se me miratimin e këtij projektligji Shqipëria është në të njëjtën linjë zhvillimi me vendet e BE-së. Gjithashtu gjatë fazës së hartimit këto akte janë konsultuar gjerësisht me palët e interesuara, duke zhvilluar të paktën 4 tryeza konsultimi me palët e interesit, me BE-së dhe me OSBE-në. Në hartimin e tyre është dhënë asistencë nga zyra e OSBE-së për lirinë e medias dhe është punuar edhe në Komisionin e Ligjeve për përmirësimin e mëtejshëm të këtyre drafteve.

Për sa më sipër vlerësohet se është i domosdoshëm miratimi i një kornize ligjore që të pasqyrojë zhvillimet në treg për të arritur një ekuilibër përmes qasjes në shërbimet e përmbajtjes online, mbrojtjen e konsumatorit dhe konkurrencën, si dhe arritjen e një gazetarie profesionale, të lirë, të pavarur, që nuk deformon debatin publik.

Sigurisht ky projektligj ka disa risi. Ndryshimi kryesor i paketës koston në propozime për ndryshime në ligjin e AMA-s, e cila tashmë nuk do të jetë vetëm organizmi që do të mbikëqyrë punën e ofruesve të shërbimit të medias audiovizive, por zgjeron fushën e veprimit tek të gjitha mediat elektronike, dhe ky është thelbi, pra atë punë që e bën për mediet tradicionale do ta bëjë edhe për mediet elektronike, duke përfshirë edhe publikimin *online*. Gjithashtu vendosja e rregullave administrative për përgjegjësitë e subjekteve që ofrojnë shërbime në medie, krahas masave me karakter penal dhe civil, që nga regjistrimi, AMA (si organ vendimmarrës), procedurat e shpejta, deri te portalet, që janë në juridiksionin shqiptar, pavarësisht ku janë regjistruar dhe për sa kohë veprojnë në Shqipëri dhe për Shqipërinë do të jenë subjekt i ligjit shqiptar dhe i monitorimit. Pra, masa që nuk bëjnë asgjë tjetër, përveç se synojnë që lirisë së fjalës t'i japin edhe peshën që meriton, duke siguruar ruajtjen e standardit demokratik, lirinë, dinjitetin dhe të drejtën për t'u informuar saktë.

Faleminderit!

Senida Mesi – E nderuar, Ministre, ju falënderoj për rezymenë dhe për informacionin! Besoj se edhe anëtarët e komisionit do ta vlerësojnë faktin që synohet më tepër rregullimi dhe jo kontrolli e medieve elektronike *online*, duke përcaktuar disa rregulla dhe vendosjen e disa standardeve etike, që të respektohe dinjiteti dhe të drejtat themelore të njeriut, por dhe cilësia e informimit dhe e diskursit politik. Dua ta përsëris që në asnjë mënyrë nuk cenohet liria e shprehjes, e mendimit, apo pluralizmi i tregut të medieve audiovizuale dhe elektronike.

Në lidhje me qëllimin dhe fushën e përgjegjësisë së Komisionit të Integritimit European më takon të bëj një koment. Duke qenë se kuadri rregullator i BE-së në fushën e komunikimeve elektronike është shfuqizuar me efekt nga data 21 tetor 2020 dhe është zëvendësuar nga Kodi European i Komunikimeve Elektronike, direktiva e BE-së 2018 nr. 1772 e PE-së dhe e Këshillit, datë 11 dhjetor 2018, Shqipëria brenda një periudhe afatmesme 2021-2022 do të duhet të ndryshojë ligjin e komunikimeve elektronike, me qëllim përafrimin e tij të plotë me Kodin European të Komunikimeve Elektronike.

Zonja Ministre, i nderuar zëvendëssekretar i Përgjithshëm i KM-së, do të doja të saktësoni pikën 5 të relacionit për ligjin në fjalë, në lidhje me vlerësimin e shkallës së përafrimit me *acquis*. Ne do t'ju nisim edhe një informacion me shkrim nga ky komision. Për sa kohë që ky projektligj nuk synon përafrimin me direktivën e BE-së, do të kërkoja marrjen e vendimit nga anëtarët e Komisionit për Integritimin European që për të dyja projektligjet, që po trajtojmë sot për dhënie mendimi, duke marrë parasysh edhe elementin që thashë, por që nuk është fushë e trajtimit të Komisionit për Integritimin European sipas nenit 19 të Rregullores së Kuvendit, të hidhet në votë që të mos trajtohen në lidhje me përafrimin me direktivën përkatëse, por të

trajtohen si pjesë. Sigurisht secili është i lirë të diskutojë e të komentojë, por jo për qëllimin e përafrimit me direktivat e BE-së.

A ta hedhim në votim?

A jeni dakord?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Patjetër, sepse dua të marr një vendim për efekt regjistrimi që nuk është në objektin e këtij komisioni.

Elisa Spiropali – Zonjë kryetare, jeni shumë e saktë. Do ta keni me shkrim që nuk synohet përafrimi me këtë legjislacion dhe është e parashikuar në PKE-në e vitit 2021, jo sot.

Senida Mesi – Patjetër që anëtarët e komisionit janë të ftuar të diskutojnë dhe të pyesin, por dua aprovimin formal për hir të funksionalitetit të Komisioni për Integrimin Europian që ne nuk do të aprovojmë këtu dhe nuk do të japim mendim në lidhje me këto dy projektligje nëse ka apo jo përafrim të pjesshëm apo tërësor. Secili prej jush e ka relacionin e departamentit përkatës për përafrimin e legjislacionit, të cilën e citova më lart. Në periudhën afatmesme 2021-2022 ky komision duhet të trajtojë të gjitha ligjet, që prekin komunikimet elektronike me qëllim përafrimin e plotë me Kodin Europian të Komunikimeve Elektronike. Për sa kohë këto dy projektligje nuk kanë qëllim këtë përafrim, unë kërkoj aprovim me votë për hir të rekordit dhe të procesverbalit për mostrajtimin në lidhje me përafrimin.

Kalojmë në diskutime dhe pyetje!

Ralf Gjoni – Faleminderit!

Së pari, faleminderit, zonja Ministre! Nuk e kuptoj pse qeveria ju ka ngarkuar juve me përgjegjësinë për të ardhur këtu, kjo nuk ishte detyra juaj sot, pasi këtu duhet të ishin ministrat përgjegjës për këtë fushë. Nuk më duket e drejtë që përgjegjësia i ka rënë zonjës Spiropali. Sidoqoftë, në relacionin që kemi nga Shërbimi për Përafrimin e Legjislacionit, na sugjerohet, si anëtarë të komisionit, që kjo nismë të kthehet te nismëtari i projektligjit dhe t'i kërkohej institucionit propozues plotësimi i tabelës së përputhshmërisë dhe dërgimi i saj në Kuvend brenda 15 ditësh. E para e punës projektligji synon përafrim me *acquis*, konkretisht me direktivën nr. 1898, datë 14 nëntor 2018, por ky projektligj nuk është shoqëruar me tabelën e përputhshmërisë, i cili analizon shkallën e përputhshmërisë së ligjit me të drejtën e BE-së. Ne kemi pasur edhe një debat të brendshëm, të cilin nuk ka nevojë ta kaloj te media, sepse u takon procedurave të brendshme të Komisionit për Integrimin Europian, për shtyrjen e mbledhjes, pasi gjykohej se kemi të bëjmë me 2 iniciativa ligjore jashtëzakonisht të rëndësishme për të drejtën dhe lirinë e shprehjes në Republikën e Shqipërisë. Nuk e kuptoj këtë urgjencën, nxitimin e këtij ligji dhe të kësaj iniciative në të gjitha komisionet parlamentare. Vetëm e vetëm që qeveria ta kalojë në parlament javën që vjen.

Meqenëse e mora fjalën, dua thjesht...

Senida Mesi – Zoti Gjoni, më kërkove fjalën për procedurë, vazhdoni për procedurë, më pas, kur të hapim diskutimin, bëni diskutime dhe pyetje.

Urdhëroni, zonja Spiropali!

Elisa Spiropali – E kuptoj shqetësimin, në fakt, në relacion ka një pasaktësi do ta quaja, por është e justifikuar, sepse që të vazhdojmë me shkallët e tjera të procesit të përafrimit, duhet patjetër që të përfshijmë konceptin e medieve elektronike në një ligj të tillë, në mënyrë që me PKE-në e radhës në vitin 2021 të mund të bëjmë përafrimin me legjislacionin e BE-së, ndryshe nuk mund të bëhej. Pra, mund ta konsideroni një hap të parë drejt përafrimit të legjislacionit. Megjithatë, për saktësi, unë e thashë, ne do t’jua nisim me shkresë, që nuk synon përafrimin me legjislacionin e BE-së në këtë fazë.

Senida Mesi – Faleminderit!

Edlira, të lutem, bashkë me ministren bëni ndryshimet përkatëse në relacion, ku të mos përmendet pika 5, që nuk synon përafrimin. Pavarësisht se ju keni përfshirë elemente dhe terminologji të direktivave të përafrimit, për sa kohë që nuk synon dhe nuk ka ardhur as tabela e përputhshmërisë, jam dakord me zotin Gjoni. Nëse do të ishte kështu, do të kërkonim, sigurisht, tabelën e përputhshmërisë dhe komentet e departamentit përkatës.

Zoti Kasneci, a keni ndonjë koment, pa kaluar në diskutime me kolegët?

Dedë Kasneci – Ne ia kemi dhënë zonjës kryetare. Ashtu siç u sqarua, përafrimi mund të jetë në frymë, por edhe në germë. Pra, ashtu siç u tha nga përfaqësuesit e qeverisë, është në frymë. Pra, futet si koncept dhe pastaj do të vijohet më tej me përafrimin. Direktiva e vitit 2018, që amendon direktivën e medieve audiovizive edhe për vendet anëtare të BE-së ka si afat për t’u transpozuar në legjislacionin kombëtar 11 shtatorin e vitit 2020. Pra, futet si koncept, pastaj do të vijohet me fazën e dytë, qoftë për ligjin e medieve audiovizive, por edhe për paketën e re në fushën e komunikimeve elektronike, Kodi European i Komunikimeve Elektronike. Duke qenë se qeveria korrigjon pasaktësitë që ka në relacion, është e drejtë... Pra, nuk është në fushën e përgjegjësisë të Komisionit të Integritetit European për të vazhduar me shqyrtimin e përputhshmërisë me legjislacionin e Bashkimit European. Për ta sqaruar, në fakt, ky ligj në momentet e fundit është futur në kalendar dhe në punime. Pra, fillimisht, kur është depozituar më korrik, nuk është vendosur nga Konferenca e Kryetarëve që të shqyrtohet nga Komisioni i Integritetit, më pas dikush ka propozuar dhe është përfshirë te Komisioni i Integritetit.

Faleminderit!

Elisa Spiropali – Në fakt, ky ligj është konsultuar me Bashkimin European dhe ne kemi pasur shkëmbim aktiv me ta, kemi edhe dokumentacionin përkatës, pra, projektligji nuk ka

kundërshtim as me frymën dhe as me geramat e ligjeve të BE-së dhe me direktivat; shkëmbimi ka qenë i vazhdueshëm. Ne e kemi komunikimin dhe, sigurisht, është një përkthim në frymë që duhet të specifikohet: të hiqet pika 5 që nuk synon përfarimin dhe ka fat deri në shtator të vitit 2020, siç e sqaroj edhe eksperti.

Senida Mesi – Zoti Balla, ndoshta donte të bënte një koment. Është e vërtetë ajo që tha zoti Kasneci që në fillim Konferenca e Kryetarëve nuk e ka bërë pjesë të trajtimit në Komisionin e Integritetit Europian, por duke qenë se në frymë janë përfshirë disa elemente...

Zoti Balla donte të bënte një sqarim.

Taulant Balla – Meqenëse, këtu mungon kryetarja e Komisionit të Integritetit Europian, e cila përfaqëson Komisionin e Integritetit në Konferencën e Kryetarëve, duke qenë se kjo paketë është në proces diskutimi prej muajsh nga ana e Kuvendit të Shqipërisë dhe ka marrë kohë, duke qenë se qeveria për çështje sensitive të këtij lloji prej vitesh tashmë ka vendosur një standard konsultimi paraprak edhe me BE-në, besoj se do të ishte në dobi të diskutimeve që anëtarëve të Komisionit të Integritetit t'u vihet në dispozicion edhe komunikimi fundor i qeverisë, i Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme, me Komisionin Europian, ku janë bërë edhe komentet për ligjin për mediet në Republikën e Shqipërisë. Komisioni Europian pikë, së pari, sqaron se në lidhje me fushën e mbulimit të monitorimit, që është pjesë e raporteve të Komisionit Europian, ky ligj nuk bie në kundërshtim. Njësia jonë e Përafrimit të Legjislacionit sapo konfirmoi që në Planin Kombëtar të Përafrimit të Legjislacionit ky ligj nuk është parashikuar tani jo vetëm për ne, por edhe për vetë vendet anëtare, sepse ky proces përafrimi legjislacioni shtrihet në kohë, pra është për vitin e ardhshëm dhe në vijim. Duke qenë se ne të gjithë biem dakord që regjistrimi i portaleve dhe i çdolloj forme të medieve është i dosidoshëm dhe ka të bëjë me transparencën qoftë të pronësisë, por qoftë edhe të garantimit të të drejtave të punonjësve, të gazetarëve që punojnë në të gjitha këto portale, biem të gjithë dakord që djem dhe vajza të reja punojnë pa qenë të siguruar, punojnë pa qenë të paguar mirë, të gjithë këta hapa duhen ndërmarrë nga ana jonë në funksion të formalizmit të këtij sektori me rëndësi për informimin e publikut. Nëse do të donit ta citoja letrën e dërguar...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Koment është.

Senida Mesi – Ia dhashë fjalën për sqarimin pse nuk ishte dhe është. *(Ndërhyrje pa mikrofon)*

E kërkuat fjalën për procedurë, jua dhashë fjalën për procedurë.

Të mbarojë zoti Balla dhe vazhdoni ju.

Taulant Balla – Pra, po ju them se, për shkak të detyrës që kam, por duke qenë si kryetar ose bashkëkryetari i Komitetit Parlamentar të Stabilizim Asociimit, dua t'ju them se

nga ana e Komisionit European flitet shumë qartë se çështjet që lidhen me... Pra, po citoj letrën e ardhur nga Komisionit European. Dua të sqaroj se çështjet që lidhen me harmonizimin *acquire*-në dhe BE-së janë të përmendura më lart dhe janë adresuar. Pa dyshim, Komisioni European na rekomandon që të fokusohemi edhe te çështjet që janë ngritur me OSBE-në. Komisioni përgjegjës në Kuvendin e Shqipërisë, ai i medieve ka bërë një punë të shkëlqyer prej muajsh për t'i adresuar një nga një të gjitha rekomandimet dhe, në një vlerësim paraprak, më shumë se 95% e këtyre rekomandimeve janë marrë në konsideratë.

Në përfundim, edhe pse jashtë fushës së mbulimit së këtij komisioni, kam qenë unë që e kam mbështetur në Konferencën e Kryetarëve që të hyjë për të marrë informacion. Edhe pse nuk ka të bëjë me tabelë përputhshmërie, pra Rregullorja e Kuvendit e involvon në mënyrë të detyrues Komisionin e Integritetit kur bëhet fjalë për tabelë përputhshmërie, por kur bëhet fjalë për një çështje, që është pjesë e procesit, le të themi historik të integritetit, të shprehet edhe ky komision. Por këtu nuk kemi të bëjmë me një tabelë përputhshmërie, pavarësisht se kemi disa direktiva, të cilat janë cituar nga raporti dhe janë pjesë e veprimtarisë, por një pjesë veprimtarie, e cila duhet për t'u përafëruar në të ardhmen. Prandaj edhe rekomandimet OSBE-së, që lidhen me sigurinë juridike, me fushëveprimin e kompetencave të medieve audiovizive, për përfshirjen e rregullimit të medieve në internet, të cilat supozohet që mund të kenë një efekt negativ në lirinë e shprehjes, pa dyshim që deri në variantin final të Komisionit të Medies, që është komisioni përgjegjës, presim që të mbyllin raportin përfundimtar. Me të mbyllur raportin përfundimtar, pa dyshim, pasi të kemi të gjitha raportet e të gjitha komisioneve, mund të japim vlerësimet tona finale, sepse, në fund të fundit, është Komisioni i Medies ai që përgatit raportin final dhe rregullimet sipas atyre rekomandimeve dhe pas një pune intensive që është bërë nga qeveria dhe nga Komisioni Parlamentar i Medieve dhe nga ai i Ligjeve. Por që të jetë e qartë për të gjithë publikun se këtu është gënjyer për ditë me radhë që Bashkimi European na qenka kundër, po ju them se nuk është kundër, përkundrazi, Komisioni European, duke qenë se OSBE-ja ka njësinë më të specializuar për këtë çështje, ka kërkuar që të punohet me te. Ne kemi punuar në këtë funksion me OSBE-në për të arritur në një draft final. Kuvendi i Shqipërisë është shprehur jo më larg se në seancën e fundit me anë të një rezolute me nevojën për t'u përballur të bashkuar, do ta quaja unë, me dezinformim. Beteja më e madhe që ka sot shoqëria shqiptare është beteja me dezinformim. Historia në këtë vend që portale të caktuara apo medie të caktuara guxojnë të përhapin panik aty ku nuk ka nevojë për panik, guxojnë të trembin shqiptarët, edhe pse jemi në një situatë posttraumatike të shkaktuar nga tërmeti, janë histori që të gjithë i ndajmë dhe nuk ka nevojë për politikë, këtu ka nevojë për t'u bërë bashkë për një gjë që ka nevojë vendi.

Faleminderit!

Senida Mesi – Faleminderit, zoti Balla!

Vazhdojmë me pyetje apo diskutime.

Zoti Gjoni ka kërkuar fjalën dhe më pas do të vazhdojë secili me radhë.

Ralf Gjoni – Faleminderit!

Atëherë që terreni medietik në Shqipëri ka nevojë për rregullim ligjor dhe për të vënë pak rregull, kjo nuk ka asnjë lloj diskutimi. Që media është një pushtet jashtëzakonisht i infektuar nga elementë politikë dhe korruptivë, të cilët sponsorizojnë një axhendë mediatike të errët, ku përfshihet *fake news*, denigrimi individit dhe i figurave publike pa u mbështetur në fakte, edhe kjo është e vërtetë. Që një ligj që quhet *liable law* ekziston në Mbretërinë e Bashkuar, në Britaninë e Madhe, ku nuk guxon një medie të përmendë një emër të një figure publike apo të një individi dhe të akuzojë dhe të hedhë akuza medietike në treg, pa e mbështetur atë me fakte substanciale, ndryshe riskon gjyqin, gjobën dhe burgun, edhe kjo nuk ka diskutim. Personalisht, e mbështes shumë modelin britanik, por ka një ndryshim thelbësor midis Britanisë së Madhe dhe Shqipërisë, kësaj baçes sonë ballkanike, neootomane. Britania e Madhe ka një institucion me reputacion botëror që quhet *Ofcom*, që është një rregullator jashtëzakonisht profesional i pavarur dhe jashtëzakonisht etik, i cili mbështet në rregulla të qarta për sa i përket rregullimit të tregut medietik: monitorim, rregullim, mbajtje e përgjegjësi nga çdo aktor i medias qoftë ajo e shkruar, e printuar apo *online*. Kuptohet, mbrohet etika dhe morali i shoqërisë britanike. Nuk ka në Britaninë e Madhe një medie serioze apo çdo lloj medie që të japë një reklamë me përmbajtje gjysmë pornografik, siç ndodh në Shqipëri në disa reklama të ndryshme. Nuk po i përmend me emra në këtë moment.

Tani ka një problem AMA, nuk është *Ofcom-i*; AMA nuk është e pavarur si *Ofcom-i*, AMA nuk ka profesionalizmin dhe kapacitetet profesionale të një *Ofcom-i* të mirëfilltë.

Shqetësimi kryesor nuk janë rekomandimet, zoti Balla, shqetësimi kryesor i OSBE-së dhe i përfaqësuesit të lartë për lirinë e medias të OSBE-së, gjithashtu edhe i Bashkimit Europian, sepse qeveria flet me Bashkimin Europian, por edhe ne si opozitarë flasim dhe komunikojmë në përditshmëri me Bashkimin Europian, me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me OSBE- në dhe me partnerët tanë ndërkombëtarë, sepse ata janë partnerët tanë si shqiptarë, nuk janë partnerët tuaj, siç mundoheni ju ta shisni, është substancial, thelbësor për këtë paketë medietike. Unë mendoj që ju si maxhorancë duhet ta lini mënjatë arrogancën që ju karakterizon dhe t'i dëgjoni me vëmendje shqetësimet jo vetëm të partnerëve ndërkombëtarë, por edhe të përfaqësuesve të medias, sepse jo të gjitha mediet janë të infektuara; kemi gazetarë shumë të mirë, cilësorë që mundohen të bëjnë punën e tyre këtu. Duhet që bashkërisht edhe me opozitën këtu në parlament të shikojmë disa çështje thelbësore. Për shembull, si mundet AMA të marrë kaq kompetenca për të rregulluar terrenin medietik dhe për të ndëshkuar dhe për të

monitoruar mediet *online*, kur këtu mund të vihet në diskutim cenimi, censurimi dhe kufizimi i të drejtës së shprehjes dhe i të drejtave të njeriut? Si ka mundësi që AMA, Autoriteti Shqiptar i Medieve, bëhet autoritet rregullator në fushën e shërbimeve të medias elektronike dhe shërbimeve të tyre mbështetëse në territorin e Republikës së Shqipërisë, ndërkohë që çdo shqiptar e di që AMA është në dorën e qeverisë? Sot jeni ju, nesër mund të jetë dikush tjetër, më autoritar se ju.

Zonja ministre ngriti disa shqetësime për sa u përket të drejtave të njeriut dhe të drejtave të qytetarit. Duhet t'i themi disa të vërteta. *Fake news* ka në Shqipëri, por nuk ka kanal më propagandistik dhe me *fake news* se ERTV-ja që dominon me arrogancë dhe me dhunë verbale hapësirën publike shqiptare. E dominon dhe e dhunon përditshmërisht shtëpinë e çdo familjeje shqiptare.

Kryeministri në seancën e fundit u tall me opozitën në parlament, e quajti gërmadhë të tërmetit të shkaktuar nga opozita që u largua në rrugë (partitë politike që janë në rrugë sot, se ata nuk janë më opozitë). Gjithashtu, tha se do ia mbyllë gojë me ligj çdokujt që flet kundër qeverisë apo kundër tërmetit e të tjera se e vendoska ky, bajraktari otoman, që shkon në Stamboll dhe thotë shtatë herë fjalën Allah për të marrë ca lekë më shumë se nuk ka lekë! Shkon atje, përdridhet para Erdoganit, përdridhet para europianëve dhe vjen e na shet dëngla në parlament duke na ofenduar ne.

Senida Mesi – A do ta ruajmë etikën e komunikimit në këtë komision?

Ralf Gjoni – Do ta ruaj.

Senida Mesi – Të paralajmërova një herë.

Ralf Gjoni – Duke na ofenduar ne si deputetë të opozitës në mënyrën më të denigruese, zonja Ministre. Ju përmendët fjalët “sharje”, “denigruese” dhe “fyese”. Unë si deputet i opozitës dhe ne si deputetë opozitarë në parlament çdo javë ndihemi të fyer dhe të denigruar nga fjalori, nga mënyra shpërfillëse dhe arrogante e Kryeministrit Rama në mënyrën se si ai i drejtohet opozitës, ose si shpeshherë ai e shpërfill opozitën në angazhimin parlamentar këtu. Ka një nëpërkëmbje javore të deputetëve të opozitës, të nismave tona dhe të mendimeve e shqetësimeve që ne shprehim në parlament. Ka një shkelje flagrante të normave morale dhe të etikës parlamentare, siç ndodh në vendet tjera europiane. Ka një investim te propaganda dhe te mashtrimi politik. Kush do ta kontrollojë këtë mashtrim politik?! AMA?! A kemi ne kapacitete tek AMA? A kemi pavarësi të mjaftueshme që AMA të rregullojë dhe të vërë gjoba ndaj një portali që, në fund të fundit, guxon dhe të akuzon për korrupsion? Nuk e kam vetëm me qeverinë tuaj. Nesër rikthehet Berisha, gjallë është ai, po vdes të kthehet në pushtet, e imagjironi se çfarë do të ndodhë?! Berisha me këtë lloj ligji në dorën e tij!

Të nderuar kolegë, do të ishte tmerr! Mendoni edhe për veten tuaj nesër në opozitë. Ka shqetësime thelbësore nga ndërkombëtarët; ka shqetësime thelbësore nga përfaqësuesit e medias; ka shqetësime thelbësore nga organizata ndërkombëtare që monitorojnë lirinë e medias në botë.

Ju lutem, të nderuar kolegë të maxhorancës, mendoj se ne duhet të trajtojmë çdo shqetësim që na vjen në parlament, para se të miratojmë një platformë dhe një paketë të tillë medietike. Kemi të bëjmë me lirinë e shprehjes në një vend që po bëhet përditë më autoritar se sa ka qenë. Për këtë arsye dëgjoni kambanën e alarmit që po na bie nga disa aktorë ndërkombëtarë dhe vendas, sepse një ditë mund të jetë tepër vonë për ju.

Faleminderit!

Senida Mesi – Faleminderit, zoti Gjoni!

Më vjen mirë që je dakord se ka nevojë për një rregullim, por, së pari, ne këtu duhet të ruajmë etikën dhe gjuhën e komunikimit.

Së dyti, për sqarim, isha edhe unë në sallën e Kuvendit kur ti thua se Kryeministri tha që do t'u mbyllë gojën medieve. Jo, nuk është e vërtetë, Kryeministri tha që në një situatë të jashtëzakonshme, të shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme në disa bashki të vendit, kur media fillon dhe abuzon, hap panik, dezinformon, sigurisht që në kushtet e gjendjes së jashtëzakonshme do t'u mbyllet edhe goja; e ke me ligj. Po zbatojmë ligjin. Jemi ligjvënës, por ne të parët nuk duam të zbatohet ligji?!

Zonja Spiropali, a keni ndonjë koment?

Ralf Gjoni – A ka terminologji në anglisht për mbylljen e gojës? Dua ta di.

Senida Mesi – Ti je anglez.

Ralf Gjoni – Nuk e imagjinoj një kryeministër europian që të thotë: do t'u mbyllem gojën.

Elisa Spiropali – Dua të sqaroj një herë e mirë që kjo nuk ka lidhje me lirinë e shprehjes, por me lirinë e shpifjes. Nuk besoj se ka ndonjë këtu që nuk e kupton rëndësinë e frenimit të kësaj sëmundjeje, që është përhapur deri në qelizat e shoqërisë dhe që buron nga një mënyrë e sëmurë e të bërit gazetari. Nuk ka fare lidhje kjo me gazetarinë normale; nuk ka lidhje me etikën; nuk ka lidhje me lirinë e shprehjes; nuk ka lidhje me otomanizmin; nuk ka lidhje me oksidentin, kjo nuk ka lidhje me asgjë që është jetike normale e njerëzore. Kjo ka lidhje me lirinë e pafre të shpifjes që 10 individë, pronarë portalesh, që kushedi nga kush financohen dhe për çfarë arsyesh të errëta dhe në cilat kanale ato parakalojnë pa asnjë lloj filtri, duan që të kenë monopol mbi shpifjen! Nuk mund ta kenë, sepse ky terren ka nevojë të normohet sipas ligjit.

Dua ta kundërshtoj zotin Gjoni për atë që tha jo vetëm për AMA-n, por për mënyrën e funksionimit. Deri tani nuk ka as një kundërshtim për vendimmarrje të njëanshme të AMA-s. Bordi rregullator i AMA-s përbëhet nga përfaqësues të shoqatave, nuk ka lidhje fare me qeverinë dhe vendimmarrja deri tani ka prekur të gjithë median tradicionale. Atëherë, cilët janë këta zotërinj që janë pronarë portalesh anonime të regjistruara kushedi ku, ku nuk mund të shkosh as të ankohesh dhe të shkosh në gjykatë e t'i hedhësh në gjyq, sepse ikin, që nxjerrin aty emra fëmijësh të abuzuar, emra grash të abuzuara, denigrojnë figura publike dhe duan të vazhdojnë të funksionojnë në këtë territor të errët? Nuk mund të funksionojnë më dhe është shumë e qartë që këto janë institucionet tona. Deri tani nuk kemi asnjë provë, as më të vogël provë, që vendimmarrja e AMA-s ka qenë e njëanshme për sa u përket medieve të tjera tradicionale me shumë më shumë peshë, vetëm përfshirjen e kësaj medie elektronike, të portaleve e me radhë në këtë normim të përgjithshëm. Interesi i 10 individëve, që janë pronarë të këtyre portaleve, që paguhen rëndshëm dhe marrin financime të ndryshme jo vetëm nga reklamat, nga ajo që duket, por edhe nga ata që nuk duken, nuk mund të kthejë mbrapsht një projektligj që i ka filluar konsultimet në dhjetor të vitit 2018. Ka një vit që hartohet ky projektligj, ka një vit që diskutohet nëpër tryeza, që konsultohet me OSBE-në dhe është 95% i rakorduar, që ka komunikim intensiv me Komisionin e Bashkimit Europian dhe nuk ka asnjë kundërshtim, që është në frymën e direktivave të BE-së.

Këta individë vijnë nëpër komisione parlamentare të fyejnë deputetët, t'i nxjerrin ata nga sallat dhe ikin e thonë se këtu po instalohet diktatura. Jo, more zotërinj, këtu po i mbyllet goja shpifjes dhe këtyre njerëzve që mendojnë se mund të lëshojnë mbi opinionin publik çdo lloj balte dhe të dalin të palagur, se paguhen nga politikanë apo për interesa të ndryshme politike! Ky është thelbi.

Patjetër, ne si maxhorancë mund të kemi çështjet tona në raport me qeverisjen, në raport me ligjin, por ne kurrë, në asnjë mënyrë, nuk i kemi rënë në qafë medias në asnjë pikë.

Zoti Gjoni mund të thotë çfarë të dojë, por ne nuk jemi nga ata që lëshojnë bojë medietike mbi letra apo bojë mbi fytyrat e njerëzve. Dakord? Nuk e kemi bërë kurrë këtë gjë dhe nuk do ta bëjmë.

Ne kërkojmë vetëm norma, ligje dhe etikë në funksionimin e medias elektronike. Kaq. Ky ligj pikërisht këtë synon. Të jeni të sigurt se do të jetë i rakorduar me partnerë tanë deri në detaje.

Faleminderit!

Senida Mesi – Po, zonja Kumbaro.

Elisa Spiropali- Ka edhe një sqarim nga zonja Kokona për ligjin.

Elira Kokona – Përsëndetje!

Unë jam Elira Kokona, drejtoreshë e departamenti ligjor në Kryeministri. Kam drejtuar grupin e punës, që në bashkëpunim me një seri ministrish dhe me ekspertët ndërkombëtarë ka punuar për tekstin teknik të kësaj iniciative.

Dua të theksoj, siç me të drejtë thotë edhe zoti Gjoni, se ekspertiza angleze ka qenë e pranishme edhe në draftin që keni parasysh, sepse një nga ekspertët e OSBE-së është një ndër më të mirët që ka sistemi britanik i të drejtës së medias. Dy ekspertët e OSBE-së, që kanë punuar për këtë draft, janë ekspertët më të mirë që ka Europa dhe jo vetëm, për të drejtën e medias dhe të drejtat e njeriut në përgjithësi.

Ne si grup teknik kemi pasur një sërë analizash para se të mbërrijmë në këtë propozim. Është e qartë që institucionet, të cilat rregullojnë aspektin procedural të veprimtarisë së shërbimit të medias... Insistoj të them edhe një herë tjetër që nuk duhet të ngatërrojmë të drejtat që i referohen medias me shërbimin që ofron medien. Ky ligj i referohet shërbimit të ofrimit të medias. Në Republikën e Shqipërisë ekzistonte një ligj që rregullonte shërbimin e ofrimit të medias në kuadër të mediumit audiovizual. Nuk mund të krijonim një ligj tjetër për faktin se mediumin audiovizual e kishim të rregulluar dhe e vetmja mundësi që ekzistonte ishte të shtonim mediumet e tjera. Mediumet e tjera të shërbimit medietik të njohura në botë janë mediumi letër, i printit, si dhe mediumi elektronik, të cilin ne e kemi futur në këtë ligj.

Pra, ne nuk ndryshuam arkitekturën ligjore të sistemit ligjor shqiptar, por mbajtëm arkitekturën tonë, duke i shtuar mediumin elektronik të ofrimit të shërbimit të medias. Ky është elementi i parë.

Elementi i dytë është që të gjithë modelet e legjislacioneve në Europë e sidomos në rajon, që janë legjislacionet më të abdejtura të shërbimit medietik, i referohen medias elektronike me ligj specifik, kështu siç e kemi edhe ne. Autoritetet që ata kanë nuk kanë një autoritet tjetër. Autoritet i vetëm është rregullatori.

Unë jam dakord me zotin Gjoni. Nuk mund të ketë autoritet tjetër. Autoriteti nuk duhet të jetë i qeverisë dhe duhet të jetë i pavarur. Kjo është arsyeja pse ne nuk krijuam një autoritet të ri, por mbajtëm autoritetin që ishte, autoritetin audiovizual. Ky është autoriteti që ka funksionuar më shumë se 10 vjet dhe organet e tij janë ato që kemi sot në këtë parashikim ligjor.

Bordi, i cili ka funksionuar deri dje, pra vetë autoriteti audiovizual deri dje, ka funksionuar me dy organe, me këshillin e ankesave dhe bordin. Të dyja organet kanë mbetur ato që janë, me të njëjtën mënyrë funksionimi. Kemi bërë një rregullim për sa i përket përputhshmërisë së veprimtarisë së tyre me respektimin e të drejtave të njeriut dhe respektimin e praktikës europiane të të drejtave të njeriut.

Një nga dispozitat e këtij ligji është që çdo lloj interpretimi i këtij ligji, çdo lloj leximi i tij, nuk mund të shkojë përtej frymës së konventës dhe përtej mënyrës se si Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut ka interpretuar lirinë e medias dhe ofrimin e shërbimit medietik.

Dua të theksoj edhe një element tjetër. Po dëgjoj shpesh se po flitet për gjoba. AMA nuk vë gjoba në lidhje me shërbimin e medias dhe të drejtën e medias. Dy janë mundësitë kur këshilli i ankesave mund të vendosë gjobë dhe janë të dyja në shërbim të procedurës, në konfirmim të së drejtës dhe lirisë së shprehjes. Njëra ka të bëjë me gjobën kur shërbimi që ofron medien nuk i përgjigjet qytetarit në kohë, pra jo në përmbajtje. E dyta ka të bëjë me *the right of reply*. *The right of reply* është një e drejtë që e kanë të gjitha llojet e legjislacioneve. E ka pasur edhe legjislacioni ynë. Thjesht e kemi specifikuar në mënyrë procedurale që e drejta e individëve për të pasur mundësinë për t'u dëgjuar dhe për të thënë të vërtetën e tyre, të jetë një procedurë e garantuar. Gjoba nuk i referohet përmbajtjes së procedurës, por vetëm aspektit procedural. Madje, për të qenë sa më të sigurt me ekspertët e OSBE-së, jemi munduar që tipologjia e rasteve kur media ka edhe të drejtën të mos përgjigjet ose të refuzojë, të parashikohet në ligj, pra për të mos e lënë fare të hapur.

Elementi i tretë që dua të theksoj ka të bëjë me regjistrimin. Kam dëgjuar shpesh në medie se ky legjislacion po detyron regjistrimin. Ky është i vetmi legjislacion, i njohur edhe nga OSBE-ja për faktin që kemi futur një mekanizëm për të cilin jemi shumë të kënaqur, që nuk detyron medien të regjistrohet.

Dua të theksoj se të gjitha mediet dhe shërbimet medietike, që ofrojnë shërbimin medietik në Mal të Zi, Serbi e Maqedoni, para se të ofrojnë shërbimin, sipas legjislacionit të tyre, detyrohen të regjistrohen në gjykatë dhe mbasi të regjistrohen në gjykatë të regjistrohen në regjistrin kombëtar të medieve.

Në Shqipëri ne nuk do të vendosim një detyrim të tillë. Ne kemi vuajtur nga censura, nga formalizmi i tepruar dhe kjo është arsyeja pse ne kemi krijuar një mekanizëm inovativ, ku nuk detyrojmë shërbimin medietik të regjistrohet në gjykatë. Pra, e kemi derregulluar në këtë kontekst, por u kemi dhënë mundësinë atyre, jo detyrimin, të regjistrohen në një regjistrin nacional, kombëtar, që të përfitojnë nga trajtimi financiar dhe trajtimet e benefitet e tjera të legjislacionit. Kjo është e vetmja shtysë që i bën mediet, që janë aty për të ofruar shërbimin, jo për të shkelur ligjet, por për të respektuar legjislacionin në fuqi, t'u japin të drejtën qytetarëve që në rast se kanë probleme me vërtetësinë e medieve, askush... Ne si grup punë kemi qenë në kontakt me shumë medie aktive. Janë të gjithë të gatshëm të ofrojnë shërbimin medietik, sepse janë aty për atë punë.

Fakti që dëgjojmë dhe shohim mundësinë se si të mos abuzohet, nuk mund të thuhet se ky rregullim bëhet për abuzuesit. Ky rregullim bëhet për ata që duan të ofrojnë shërbimin në

respekt të plotë të legjislacionit në vend dhe ata që duan ta ofrojnë këtë shërbim kanë ide të qarta se çfarë duhet të bëjnë dhe si duhet të veprojnë. Pra, të lexosh legjislacionin, gjithë frymën e tij dhe këto rreshta, me idenë e cenimit dhe kufizimit të abuzuesve është njëra ana e medaljes. Ana tjetër e medaljes është që të gjithë ata që kanë respekt për veten e tyre, për profesionin që ushtrojnë dhe e ofrojnë si shërbim, duhet të kenë rregulla të qarta. Ky legjislacion nuk bën asgjë më shumë nga çfarë bëjnë legjislacionet e vendeve të rajonit.

Nga një sërë shoqatash, që mendoj se duhet të kishin ofruar kontekst dhe duhet të kishin dhënë kontribut shumë më konstruktiv, deri tani ne si grup pune, në të gjitha tryezat që kemi bërë, nuk kemi marrë kontribute konkrete në dispozita konkrete. Shpresoj që Komisioni i Ligjeve të mund të marrë kontribut konkret. Diskutimet e vetme kanë qenë për sa i përket vlerësimit në përgjithësi, por asnjë diskutim për sa i përket frymës specifike të argumentit.

Faleminderit!

Senida Mesi – Zonja Kokona, të falënderoj shumë!

Më lejo të bëj një koment.

Të falënderoj që ishe sot këtu, pavarësisht se ne nuk të kishim në listën e të ftuarve! Të falënderoj jo vetëm për pozicionin që mbulon në Kryeministri, por edhe për ekspertizën dhe eksperiencën që solle!

Unë do të doja që ekspertë të tillë të fushës të ishin shumë më të pranishëm në tryezat tona, në komisione dhe në diskutime me deputetët, për rezymenë që ju sapo bëtë, duke na treguar procesin, përfshirjen e individëve në proces, çfarë kanë prekur dhe çfarë kanë synuar ndryshimet ligjore në arkitekturën ligjore, jo vetëm për anëtarët e këtij komisioni, por edhe për ata që na kanë dëgjuar.

Unë do të doja që me të njëjtën terminologji të flasim nga ana teknike, jo të bindim opinionin publik, por ta informojmë atë se çfarë po bëjmë.

Zonja Kumbaro, më fal për...!

Mirela Kumbaro – Faleminderit!

Duke falënderuar zonjën ministre dhe zonjën Kokona, të cilat, në njëfarë mënyre, më paraprinë ato që doja të ndaja, duke marrë shkas nga fjala e zotit Gjoni dhe nga çfarë dëgjojmë të përmendet në mënyrë paksa abuzive, dua të them se ky ligj (jemi në një komision, jemi ligjvënës, ligjbërës) nuk është ligji i shpifjeve, nuk është paketa antishpifje, por është (e cituar saktësisht) propozim i projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.97/2013 “Për mediet audiovizive në Republikën e Shqipërisë””! Pra, ne nuk po bëjmë një ligj të ri, por një amendim të një ligji ekzistues.

“AMA, AMA, AMA...” Nuk po e krijojmë ne AMA-n me këto ndryshime. AMA ekziston. Çdo ligj bëhet për të reflektuar disa realitete që evoluojnë.

Në fushën e medieve kemi një realitet të evoluar fuqishëm e vrullshëm jo vetëm në Shqipëri, por në të gjitha vendet, që janë mediet *online*.

Më vjen shumë mirë që në disa citime saktësohen publikimet *online*, që presupozojnë një proces mbrapa editimi, mendimi dhe reflektimi të organizuar, pra jo çdo deklaratë që bën çdo individ në faqen e vet të *facebook*-ut! Kjo thuhet shumë qartë.

Nga ana tjetër, kam përshtypjen se ndoshta nuk kemi marrë kohën e duhur para se të shprehemi me zë, për ta lexuar rresht më rresht ndryshimin dhe për të lexuar jo vetëm një tekst, por në radhë të parë versionin e fundit që ka dërguar qeveria, Ministria e Drejtësisë, mbas reflektimit të rekomandimeve të fundit të OSBE-së, të cilat u bënë publike edhe pak ditë më parë në faqen e OSBE-së.

Para dy ditësh në Komisionin e Informimit Publik, ku jam edhe anëtare, patëm një diskutim shumë të gjatë në një dëgjese me të gjitha palët e partnerëve tanë ndërkombëtarë, me OSBE-në, BE-në, Këshillin e Europës dhe PNUD-in, për punën e bërë. Përfaqësuesja e OSBE-së theksoi në mënyrë shumë të qartë se kjo nuk është një punë që ka filluar sot. Ishte ajo që tha se ky konsultim midis hartuesve të këtyre ndryshimeve dhe ekspertëve të OSBE-së ka filluar në dhjetor të 2018-s dhe që nga ajo datë sot bëhet fiks një vit, ku versione të ndryshme të plotësuara dhe të përmirësuara (po citoj ekspertin e OSBE-së) janë hedhur në publik, janë ndarë me publikun dhe prej muajsh, në dijeninë time, janë në faqet *online* të qeverisë dhe të Kuvendit, për konsultimin publik.

Dua të theksoj se, nëse kemi një evolucion të medieve nga medie audiovizive në medie *online*, ky ligj nuk bën gjë tjetër veçse zgjeron një instrument rregullator të medias klasike dhe tradicionale në mediet e reja, ndërsa kur thuhet se AMA vë gjoba (do ta rimarr edhe një herë në një mënyrë më pak formale dhe me një gjuhë më pak teknike atë që tha zonja Kokona, sepse është shumë e qartë në të gjitha plotësimet që janë bërë dhe në versionin e fundit) nuk është AMA si e tillë. Drafti ka pasur kujdes që edhe në versionin e parë, kur thuhej tërë kohën “mbledhjet e AMA-s, anëtarët e AMA-s, vendimet e AMA-s”, të saktësojë mbledhjet, vendimet, rregullat e bordit të AMA-s dhe bordi i AMA-s nuk janë nëpunës të shtetit shqiptar, por përfaqësues shumëpalësh, të cilët debatojnë, janë kundër apo pro, dhe arrijnë në konkluzione. Mua më duket se, pavarësisht nga paragjykimi që mund të keni, gjithë këto vite, në kujtesën time, nuk ka ndodhur ndonjë rast ku AMA në raport me fushën e vetë të veprimit, që janë mediet audiovizive, të ketë pasur raste flagrante ku të ketë gjobitur për qëllime politike apo klanorë një medie apo një tjetër. Kështu që nuk besoj të kemi precedentë të tillë që të na bëjnë të paragjykojmë që veprimtaria e bordi të AMA-s të jetë paragjyquese për mediet *online*. E para.

E dyta, po kështu në nenin 20 saktësohet se do të jetë Këshilli i Ankesave që do të marrë ankesat nga subjekte të ndryshme. Ju, zoti Gjoni, përmendët pak më parë figurat publike, singerisht, për mua është shqetësimi im i fundit. Kur marrim përsipër të jemi figura publike, kur marrim përsipër të jemi të zgjedhur dhe kur marrim përsipër të jemi personazhe të jetës politike, kemi marrë përsipër edhe koston publike që sjell kjo, kemi marrë përsipër të durojmë të përballojmë edhe cenimin, edhe fyerjen. Kjo gjë ndodhi pak më parë në komisionin tjetër, por kjo është pjesë e detyrës sonë, e dimë që nuk bëhet...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E pranoj që ju nuk jeni dakord, por e kemi marrë përsipër këtë kosto. Që kur e kam pranuar këtë detyrë, e dija që do ta kisha edhe këtë kosto, por shqetësimi im më i madh është se kemi qenë të gjithë dëshmitarë të të miturve, të përdorimit të pornografisë, të bulizmit, racizmit, të thirrjeve, të cilat krijojnë panik dhe ndjesë paçin edhe viktimat që janë shkaktuar në dy fatkeqësitë e fundit, sidomos edhe të manipulimit që mund t'i bëhet medias *online* në mënyrë të fshehur qoftë edhe për një fakt, tashmë të ndaluar me ligj, që janë lojërat e fatit, të fshehura.

Po shikoj me kuriozitet për të kuptuar ekspertët e OSBE-së se cilat versione apo modele të tjera kanë parë bashkë me drafthartuesit tanë dhe, në fakt, i ishin referuar shumë modelit gjerman, në të cilin lexojmë që ajo që quhet gjobë, penalizim apo ndëshkim, aplikohet në Gjermani kur kemi të bëjmë me një shkelje nëse ofruesi i rrjetit social nuk arrin të sigurojë një sistem për të trajtuar ankesat siç duhet, nuk i monitoron ato në mënyrë korrekte, nuk arrin të korrigjojë një mangësi organizative ose ta korrigjojë atë në një kohë të përshtatshme. Ky është modeli gjerman.

Të njëjtën gjë propozojnë edhe këto ndryshime, që gjobat, ndëshkimet apo ato që quhen shkelje ndodhin në rast se ofruesi i shërbimit të publikimit *online* nuk i përgjigjet subjektit, qytetarit, ankimuesit, e thënë shkurt, kur ai pretendon se i është shkelur një e drejtë. Pra, nuk i përgjigjet brenda afatit 7 ditor dhe gjobitet për mospërgjigjen.

Ka edhe një shkallë interesante ankimimi, që nuk e kemi në versionin ekzistues të ligjit, brenda për brenda dy organizmave vendimmarrës të AMA-s, nga Këshilli i Ankesave te bordi i AMA-s, pastaj të lind sërish e drejta të shkosh edhe në gjykatë.

Unë besoj se kjo lehtëson aksesin e qytetarëve në rrugët legjitime të ankimimit, nga ato që janë administrative deri te gjykata, që prapë mbetemi në administrative. Kështu që, në këtë kuptim, ndoshta kemi nevojë ta lexojmë në mënyrë më të detajuar edhe krahasimore në radhë të parë me atë që kishim, ku praktikisht kemi vite, që në vitin 2013 që e bashkëjetojmë, edhe me modelet e tjera europiane. Të abuzohet nga ana tjetër, që janë të gjitha organizmat ndërkombëtare kundër, edhe këtë më vjen keq...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Është dezinformim.

Ishim në një seancë shumë të gjatë me ta, po flas në cilësinë e anëtares së Komisioni të Medias dhe Informimit Publik, ku praktikisht, i vetmi shqetësim final, të cilin ende nuk e kishim reflektuar, po çka jemi duke bërë, është të vazhdohet të bëhen konsultimet, të cilat po i bëjmë në një aktivitet maratonë.

Ndërsa mora listën e fundit të propozimeve të OSBE-së dhe draftin final që na ka ardhur nga qeveria, i gjej të reflektuara aq sa ndoshta mund të vijnë në të njëjtin krah me qeverinë dhe na japin shpjegime për tekstin që kanë hartuar.

Faleminderit!

Senida Mesi – Fjala për zonjën Mara, zotin Papa dhe më pas zotin Ulqini.

Aurora Mara – Faleminderit!

Zonja Ministre, ju falënderoj për relatin! Ishit shumë e qartë për pikat e prekura në bazë të ndryshimeve të kërkuara, gjithashtu edhe stafi juaj ishte shumë i qartë. Ju falënderoj!

Jam njohur paraprakisht me të dyja propozimet, të cilat, pasi kanë kaluar në parim në Komisionin e Ligjeve, përpos ndryshimeve që u elenkuan edhe nga kolegët më parë me shumë qartësi, jam dakord me to dhe sipas meje, janë të domosdoshme, por do të ndalem në tri qëllimet kryesore të kërkesës së këtyre ndryshimeve që po diskutojmë sot.

Qëllimi kryesor është përcaktimi i standardeve etike duke harmonizuar të drejtat dhe liritë themelore në mënyrë që njëra e drejtë themelore të mos cenojë të drejtën tjetër.

Qëllimi i dytë po ashtu shumë i rëndësishëm, është kontrolli ligjor për dizinformimin, që është një dëm shumë i madh që i bëhet shoqërisë sonë.

Qëllimi i tretë, i cili vjen si pasojë e dy qëllimeve të para shumë të rëndësishme, është rritja e standardeve të medias *online*.

Të nderuar kolegë, unë elenkova tri qëllimet kryesore bazë të kësaj pakete kërkesash të ndryshimeve për sa i përket medieve audiovizive dhe komunikimeve elektronike. Duke u nisur nga këto tri qëllime kryesore, mendoj se duhet të jemi të gjithë të një mendjeje, që ta miratojmë në parim, sepse është në të mirën e shoqërisë sonë dhe standardeve të medias që kemi sot për sot.

Faleminderit!

Kostaq Papa - Fillimisht, do të doja të ndërhyja për një aspekt teknik, por, meqë kaluam edhe te komentet, po i bëj të gjitha bashkë.

Aspekti teknik ku do të doja të ndërhyja ka të bëjë me disa shprehje ligjore të shprehura në relacionin e shërbimeve tona të brendshme. Togfjalëshi “nuk synon të përafrojë” në lidhje me legjislacionin europian, nuk është etik dhe profesional. Edhe kur ligjet apo relacionet tona

vërtet nuk shprehin togfjalësia, ligje, nene që kanë lidhje me legjislacionin europian, sërish ligjet shqiptare, jo sot, por edhe prej shumë vitesh, do t'jua them edhe kur, janë gjithmonë të fokusuara dhe ndriçuara nga legjislacioni i Bashkimit Europian. Kjo jo tani në momentin ku kërkojmë datën e futjes në negociim, por edhe kur u vendos data për Marrëveshjen e Stabilizim-Asocimit vite më parë, për të mos thënë edhe më parë kur ne bënim marrëveshje dhe konventa me shtete të Bashkimit Europian, ligje të cilat, duke u integruan në ligjet tona ndikonin dhe ishin pjesë e përafrimit të legjislacionit.

Kështu që duhet hequr kjo si fjalë “nuk synon të përafrojë”, sepse tingëllon keq. Të gjitha ligjet tona synojnë përafrimin, edhe kur nuk e kanë të shprehur, sepse e kanë në frymën e ligjit në mënyrë të përhershme, në mënyrë kategorike, sepse bashkëveprimi, ndërveprimi dhe sinkronizimi ligjor me legjislacionin e Bashkimit Europian është detyrim, edhe para Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit, në qoftë se ne kemi bërë marrëveshje me këto vende, edhe sot sidomos.

Gjëja tjetër që do të doja të shprehesha ishte në lidhje me komentin për disa aspekte teknike që kanë lidhje me ligjin.

Është bërë një zhurmë e madhe dhe ka elemente që prekin, cenojnë ose gravojnë që shoqëria, pjesa e medias apo edhe ne të kemi ndikimin tonë personal dhe shoqëror. Jam dakord me ato çka duhen prekur të ligji në lidhje me punësimin e gazetarëve dhe sigurimet shoqërore të tyre, që kanë të bëjnë me punën e zezë të gazetarit. Kjo duhet të jetë në qendër të vëmendjes.

Tjetra, tatimi i reklamës apo i produktit të portaleve, që është një element që del jashtë ligjit që po shqyrtojmë, denigrimi i personit, për këtë doja të flisja i fundit, se jam dakord me zonjën Kumbaro, që kemi marrë pjesë të riskut qoftë në mënyrë të parregullt, qoftë edhe pa të drejtë, portalet dhe mediet e tjera mund të na prekin, kjo është e fundit që duhet të trajtojmë, sepse duhet të shohim rëndësinë për të cilën kemi ardhur këtu, të firmosim apo të nënshkruajmë apo bashkëveprojmë politikisht. Është më e rëndësishme kjo. Le të na shajnë, edhe mua më kanë sharë pa të drejtë fare.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kryeministri është tjetër pozicion. Do ta ndajmë në pozicion tjetër.

Aspekti tjetër është problemi i pronësisë së këtyre portaleve. Kjo është thembra e Akilit që duhet parë për qarkullimin e parave të paligjshme e ku di unë çfarë problemesh të tjera mund të dalin. Po ashtu, edhe për etiketimin ose përpjekjen për të bërë regjistrimin e medieve *online*, do të shohim ligjet më të mira botërore. Situatat në lidhje me mediet *online* evoluojnë shpejt, por parë nga shumë aspekte, do të konsultohemi me të tjerët që janë më të mirë nga ne.

Një sqarim tjetër ka të bëjë me sensibilizimin për këtë projektligj. Jam dakord, e kam shprehur edhe te Komisioni i Medies, që i bën mirë sensibilizimit dhe kohezionit shtyrja e këtij

projektligji ose pakete ligjore te draftbërësi për arsye të shumta, por më shumë është sensibilizimi dhe kohezioni social i sotëm, problematikat që ka krijuar, dimensionet dhe kundërshtitë që një pjesë mund të jenë të ligjshme, një pjesë janë të pajustificueshme dhe kanë të bëjnë me krijimin e një opinioni dhe një agravimi të situatës sociale.

Kjo ishte ndërhyrja që doja të bëja. Nuk po hy në draft dhe në problematikat që ka brenda, sepse ato do t'i shohim në Komisionin e Medies nen për nen, parafjalë pas parafjale dhe togfjalësh pas togfjalëshi.

Faleminderit!

Senida Mesi – Fjala për zotin Ulqini.

Musa Ulqini – Faleminderit, zonja drejtuese!

Në qoftë se nuk do të fliste zonja Kokona, unë nuk do të flisja, por tani e kam të pamundur të mos them diçka, do të flas një deputet që i ka ndjekur ndryshimet në legjislacionin e medieve që në vitin 1992 si anëtar i këtij komisioni dhe si relator i këtij ligji. Në këta 20 vjet nuk mbaj mend të ketë pasur në komisionin tonë një reagim aq agresiv nga të ftuarit, të cilët kanë qenë të shumtë në numër, pasi kanë përfaqësuar grupe interesi, shoqata e medieve, trupa akademike dhe institucione ndërkombëtare sa i takon projektit në fjalë. Kam ndjekur me shumë vëmendje se çfarë është diskutuar kohët e fundit; komentet e “Zërit të Amerikës”; çfarë tha dje përfaqësuesi i Komisionit të Helsinkit pranë Kongresit Amerikan në prani të delegacionit tonë; çfarë ka deklaruar përfaqësuesi i zyrës së OSBE-së. Kam këtu 15 organizata shqiptare, 7 janë ndërkombëtare përpos këtyre, të cilat kanë sjellë deklaratat e tyre dhe kërkojnë që ne mos ta miratojmë ligjin. Jam përpjekur ta kuptoj reagimin e tyre dhe për këtë kam 3 mendime, por çështja e fundit është ajo që këmbëngul më shumë.

Një pjesë e këtij reagimi ka të bëjë me një luftë të pastër politike dhe disa nga ata që erdhën, jua garantoj që ishin politikisht shumë herë më agresivë sesa vetë trupa politike që përfaqëson sot opozitën. Nuk kam komente për këtë çështje, e mirëkuptoj. E para.

E dyta, kishte një reagim histerik nga disa përfaqësues, për shkak se ky ligj prek interesa të mirëfillta private. Pra, të pranishmit ishin në konflikt të pastër interesi, pasi ky ligj vendos rregulla në një treg të parregulluar dhe që keqpërdoret dhe kjo është një arsye e fortë që unë vendosmërisht të jem në anën e këtij projekti.

E treta, kam dëgjuar shumë pasaktësi nga ata që ju përmenda më lart si shqiptarë dhe ndërkombëtarë. Mendoj që kjo lidhet me mënyrën se si qeveria, dy ministritë tona, grupi që e ka hartuar këtë projekt e kanë publikuar, mbrojtur dhe informuar opinionin publik, median dhe të gjithë. Nuk kam dëgjuar mbrojtje më të cekët sesa mbrojtja që i bënë dy përfaqësuesit e qeverisë në komisionin tonë. Deri më sot nuk kam dëgjuar gjëra më të sakta, jo e justifikojnë, por kërkojnë që ne ta miratojmë më shpejt projektin sesa shpjegimi që na dha këtu zonja

Kokona, ky është thelbi i gjësë. Të ngatërrosh çështjen e gjykatës, sepse sipas tyre ne po u heqim të drejtën qytetarëve të ankohen të gjykatë kur AMA merr një vendim është një e pavërteta e madhe, sepse kjo është një liri kushtetuese. Të shpjegosh se çfarë është regjistrimi, i cili nuk ka të bëjë fare, sepse ashtu siç paraqitet edhe nga ndërkombëtarët, nuk po them nga ana e shqiptarëve, por e kam fjalën për përfaqësuesit politikë që ishin atje, të cilët me demok përfaqësonin grupe të caktuara, OJQ, ata i mirëkuptoj, si ka mundësi që këto gjëra nuk janë shpjeguar.

Zonja Ministre, më besoni nuk ka informacion. Unë nuk pres nga Mark Marku&kompani që ata të vijnë me ligjin e lexuar, sepse ata nuk e lexojnë ligjin, por vijnë këtu e kundërshtojnë dhe e quajnë ligj “fashist”. Ky nuk është një ligj fashist, por është një përpjekje për të rregulluar nën frymën e BE-së, me standardet më të përparuara një problem që ka lindur në gjithë botën, që diskutohet sot në SHBA, që rrezikon këto *fake news*-e. Media e re elektronike rrezikon të devijojë gjërat themelore si funksion demokracia në SHBA, siç janë zgjedhjet, po kështu edhe në BE. Për këtë miratuar një dokument shumë të rëndësishëm në parlamentin e Shqipërisë, sepse është një problem dhe një shqetësim i madh. Ne duhet të jemi në sinkron me atë çfarë na kërkojnë qytetarët, sepse përfaqësojmë interesat e tyre, nuk përfaqësojmë as portale, as klikime dhe as gjëra të tjera. Çfarë do t’u themi 200 mijë shqiptarëve, që për shkak të një *fake news* nën një stres të madh braktisën shtëpitë, duke krijuar probleme të mëdha emocionale dhe shëndetësore? Është detyra jonë të reagojmë. Si ka mundësi që këto shpjegim që na bëtë këtu nuk janë përçarë ashtu siç duhet?

Kam shumë emocione kur i them këto gjëra. Unë futem në grupin e atyre që duan të jenë konstruktiv, jam relator. Edhe unë, që e kam studiuar me themel, po ju them se disa gjëra nuk isha në gjendje t’i formuloja. Këtu kemi një dokument të qeverisë dhe as këtë dokument që ka sjellë qeveria të mos jenë në gjendje përfaqësuesit e qeverisë ta mbrojnë, nuk dua t’i bëj keq askujt se nuk jam këtu për të krijuar probleme, por detyra jonë është t’i vëmë në dukje këto gjëra. Duke qenë mbështetës i flaktë i këtij projekti mendoj se projekti ka nevojë për disa rregullime dhe saktësime, të cilat më shumë janë teknike nga pikëpamja ligjore, por që keqpërdoren qëllimisht.

Kjo seancë ishte serioze dhe për këtë dua të falënderoj zonjën ministre dhe besoj se kjo betejë ende nuk është mbyllur. Nëse ky ligj është kundër dezinformimit, detyra jonë është të bëjmë një betejë për t’i informuar shqiptarët dhe ndërkombëtarët se jemi duke bërë diçka të mirë për qytetarët shqiptarë.

Faleminderit!

Senida Mesi – Faleminderit, Musa!

Fjalën e ka zonja Hyseni.

Edlira Hyseni – Përshëndetje!

Ju falënderoj për prezantimin!

Që në fillim të mbledhjes, nënkryetarja na e bëri të qartë se komisioni ynë sa i takon këtij projektligji është për dhënie mendimi, gjë që lidhej me përafrimin me direktivat e BE-së, por sipas atyre që u shprehën nuk synohej ky përafrim. Mbledhja në të tilla raste do të kishte mbaruar ende pa u nisur...

(Diskutime pa mikrofon)

Kështu e nisët në fillim, por mendoj se debati i sotëm ishte shumë konstruktiv. Unë kam qenë pjesë edhe në dhënien e mendimeve nga ana e zëvendësministrit në Komisionin e Veprimtarisë Prodhuese.

Ky projektligj ka një ndjeshmëri të madhe publike kështu që qytetarëve të informuar apo të dezinformuar u është krijuar thjesht paniku se po bëhet diçka për t'u censuruar fjalën dhe mendimin e lirë. Nuk mendoj se i gjithë ky dezinformim është bërë në mënyrë të qëllimshme, ndoshta ka munguar informacioni, por është mirë që disa gjëra të jenë të qarta dhe të gjithë bashkë të kuptojmë se për çfarë bëhet fjalë.

E para, kur flasim për publikime elektronike u referohemi portaleve, por ndërkohë flasim edhe për përgjegjësinë që kanë individët në shprehjen e tyre publike nëpërmjet rrjeteve sociale, apo jo, në mos gaboj...

(Diskutime pa mikrofon)

Jo?

(Diskutime pa mikrofon)

Në këtë mënyrë është komentuar, sepse nuk flitet vetëm për mediet dhe portalet, por flitet edhe për shprehjen, ku nëpërmjet rrjeteve sociale persona publike dhe jopublike mund të ndajnë opinione. Ky është një element që u ka krijuar të gjithëve dilemën nëse janë subjekt i këtij ligji, nëse janë vetëm individët e thjeshtë apo vetëm mediet dhe portalet.

(Diskutime pa mikrofon)

Ky fakt është i rëndësishëm të sqarohet, sepse është konceptuar si një ndryshim që prek edhe individët e thjeshtë.

E dyta, zonja Kumbaro u shpreh se nuk duhet quajtur paketë antishpifje, pasi ka një titull të vetin. Në fakt ky ligj kështu është prezantuar edhe nga vetë maxhoranca dhe Kryeministri si një paketë antishpifje...

(Diskutime pa mikrofon)

Po më këtë mënyrë njihet si paketa antishpifje.

Në komision parafolësit u shprehën se OSBE-ja ka rënë dakord me korrigjimet që i janë bërë draftit. Dua të di nëse OSBE-ja ka dhënë edhe një opinion me shkrim lidhur me këtë draft? A është ky drafti final i dakordësuar me OSBE-në?

Ju u shprehët se OSBE-ja kërkon që konsultimet duhet të vazhdojnë më tej me publikun dhe palët e interesit. Kur thuhet të shtohen konsultimet keni marrë parasysh që vetëm duhet t'i dëgjojmë apo t'i marrim parasysh edhe opinionet e tyre? Me aq sa kam dijeni, palët e interesit, në këtë rast përfaqësuesit e medieve, nuk kanë qenë dakord, duke e kundërshtuar këtë ligj, pasi e perceptojmë si një censurim të punës së tyre. Nuk besoj se qëllimi themelor i këtij ligji është ai që tha zoti Balla, që lidhet me formalizimin e gazetarëve, pasi kjo është detyrë dhe përgjegjësi e administratës tatimore, të cilët nëse gjejnë punëtorë në të zezë apo të padeklaruar duhet të marrin masat përkatëse.

Gjithashtu, zoti Ulqini u shpreh se janë 15 shoqata kombëtare dhe 7 ndërkombëtare, të cilat e kanë kundërshtuar këtë ligj, është diçka preokupuese, nuk është politike. Pra, kemi një perceptim që është një nismë ligjore thjesht për qëllime politike që censuron sot opozitën. Ky ligj do të ngelet për fuqi për shumë kohë, kështu që nuk besoj të jetë e qëllimshme, sepse sot mund të penalizohet njëra palë, ndërsa nesër penalizohet tjera, të gjithë e mendojnë të nesërmen.

Ka një ndjeshmëri dhe panik në opinionin publik që ky ligj do t'i censurojë të gjithë në mendimin dhe fjalën e lirë. Ju na e shpjeguat që nuk është kështu, por perceptimi gjithsesi ngelet ky. Ngjashmëria e këtij ligji me ligjet e disa vendeve si Gjermania, Letonia, Mali i Zi, Kroacia, ku nga kjo e fundit po imitojmë edhe ligjin e fiskalizimit, duke e marrë si model referues, është i pakët. Nëse nuk synohet përafrimi me direktivat, por as në kundërshtim me to, siç u shpreh zoti Balla, pse është e domosdoshme dhe urgjente në këto momente ku ndjeshmëria publike është e madhe, ku ka problematika të tjera të natyrës ekonomike, financiare, pse t'u shtojmë edhe një preokupim tjetër njerëzve kur ende nuk është detyrim i direktivave të BE-së? A nuk ka mundësi të pritët pak para se të shtrohet për miratim në Kuvend?

Faleminderit!

Senida Mesi – Faleminderit!

(Diskutime pa mikrofon)

Zonja Ministre, besoj se sqarimet kanë qenë mëse të mjaftueshme.

Ju falënderoj për komentet, pavarësisht se qëllimi ynë nuk ishte që ky ligj të zgjatej kaq shumë, por t'i qëndronim funksionit të këtij komisioni, duke marrë parasysh kërkesat dhe dëshirën tuaj për të diskutuar disa nene të veçanta, për disa meraqe që kishin si përfaqësuesit e opozitës dhe të pozitës për të theksuar ato gjëra që fatkeqësisht nuk kishim mundur t'i sqaronim

ashtu siç duhej në mbledhjen e mëngjesit si rezultat i gjuhës dhe i komunikimit të papranueshëm.

Komisioni i Integritetit Europian në mbledhjen e zhvilluar në datën 12.12.2019 bazuar në nenet 18, 34 dhe 36 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë dhe në ligjin nr. 15/2015, duke marrë parasysh që projektligjet e parashikuara në rendin e ditës së sotme nuk janë kompetencë e Komisionit të Integritetit Europian, vendosi mosvijimin e procedurës për votim të projektligjeve sipas rendit të ditës sa i përket procedurës së përafrimit.

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA